



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë të nenit 5 pika d të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Ligjit për Arsimin Parauniversitar nën 35 pika 1, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 08/2014, për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe të zëvendës-drejtorit të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjiçan, rishpall :

K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

-I- Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “Fetah Qerimi” në Verbicë të Zhegocit

- Pozita : Drejtor

-II- Shkolla e Mesme e Lartë e Artit Pamor “Adem Kastrati ” në Gjiçan

- Pozita : Drejtor

Përshkrimi i punëve : Udhëheq institucionin dhe është përgjegjës për :

- Zbatimin e ligjshmërisë,
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorë e tjerë të arsimit,
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlikuara të praktikës,
- Caktimin e masave disiplinore ndaj nxënësve,
- Detyrat lidhur me kurrikulumin,
- Planifikimin, udhëheqjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve në Institucion,
- Zhvillimin e një plani afatmesëm dhe aftgjatë për aktivitetin e Institucionit,
- Qështjet e tjera që rregullohen përmes këtij ligji.

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs :

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit themelor (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore,
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit,
- Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim.
- Të kenë 3 (tri) vite përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

Dokumentet e nevojshme:

- Certifikata e lindjes,
- Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës,
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Portfolion profesionale,

- Letërreferencë nga një institucion publik – kredibil (si Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli drejtues i shkollës , punëdhënësi paraprak , Institucionet e Arsimit të lartë. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake.
- Planin zhvëllimor të institucionit edukativo arsimore dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12: arial sipas udhëzimeve të MASHT-it,
- Qertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore,
- Dëshminë se nuk është nën hetime,
- Kopja e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohet, ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ, nr. 8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Kohëzgjatja e kontratës: sipas Udhëzimit Administrativ 8/2014 (4 vite).

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga dita e shpalljes në gazeta zyrtare.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në Gjilan.

Drejtori
Nazmi Musa